

VENDIM
Nr.851, datë 19.12.2003

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË PALUAJTSHME, QË
PREKET NGA NDËRTIMI I DEPOS SË UJIT TË UJËSJELLËSIT TË POLOSKËS
NË QENDËR, DEVOLL TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i depos së ujit të ujësjellësit të Poloskës, Qendër, Devoll.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Qendër, Devoll.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që i bashkëngjitet këtij vendimi, për sipërfaqen 400 m² tokë/are, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri "Investime", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 126 600 (njëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2003, miratuar për komunën Qendër, Devoll.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.12.2003.
 7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, prefektura e qarkut të Korçës dhe komuna Qendër Devoll për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lista emërore e pronarit që do të shpronësohet për ndërtimin e depos së ujit të ujësjellësit
të Poloskës, Devoll

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Sip/tokës m ²	Njësia lekë m ²	Vlera lekë
1.	Haxhi Hysen Gjoza	400	1000	400.000
	Shuma	400		400.000